



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivry	06.04.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SH/01	3357/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.739/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit Anr.2471 të datës 31.01.2023 ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.739/2021 të datës 19.08.2021 të parashtruar nga ankuesi Basri Rexha, përmes përfaqësuesit të autorizuar, avokatit _____ me adresë Rr.UÇK, nr.24/1-Prishtinë, kundër masës disiplinore “Vërejtje” të datës 30.07.2021, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.04.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.739/2021 e datës 19.08.2021, e parashtruar nga ankuesi _____, ashtu që anulohet masa disiplinore e vërejtjes e shqiptuar me datë 30.07.2021 ndaj ankuesit, dhe të gjitha veprimet tjera që kanë rrjedhur si pasoje e kësaj mase disiplinore.

III. Obligohet Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin, duke larguar nga dosja personale e nëpunësit civil, masën disiplinore të anuluar si në pikën II të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale, më datë 19.08.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4279/2021 të regjistruar nën shenjë A.nr.739/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës

disiplinore të vërejtjes të shqiptuar ndaj tij, me datë 30.07.2023 nga Drejtoresha e Inspektoratit Farmaceutik pranë Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 19.08.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale, ndërsa kjo e fundit me datë 02.09.2021 ka përcjell përgjigjen se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit nuk ka mundur që të shqyrtoj dhe të vendos për ankesën e datës 19.08.2021, dhe si rrjedhojë ankuesi ka vazhduar konfliktin administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Kjo e fundit, pas pushimit të rrethanave të cilat kanë penguar shqyrtimin e ankesës, me Aktgjykimin A.nr.2471/2021 të datës 31.01.2023 ka detyruar Këshillin që të shqyrtoj dhe të vendos për ankesën e datës 19.08.2021 të parashtruar nga ankuesi Basri Rexha.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr.2471/2021 të datës 31.01.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës është pranuar me datën 03.03.2023 dhe është protokolluar me numër 2270/2023; Ankesën me numër të protokollit 4279/2021 të datës 19.08.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 13.07.2021 të drejtuar ankuesit; Emalin e datës 15.07.2021 të drejtuar ; Emalin e datës 14.07.2021 të drejtuar Emalin e datës 14.07.2021 të R.Thaqi drejtuar , Emalin e datës 14.07.2021 të drejtuar drejtuar Emalin e datës 15.07.2021 të drejtuar ; Emalin e datës 15.07.2021 të drejtuar Ankesën ndaj vërejtjes së datës 15.07.2021; Emalin e datës 16.07.2021 të drejtuar Emalin e datës 30.07.2021; Emalin e datës 30.07.2021 të drejtuar Emalin e datës drejtuar Emalin e datës 30.07.2021 të drejtuar ; Emalin e datës 15.07.2021 të R.Thaqi drejtuar ; Emalin e datës 14.07.2021 të drejtuar ; Emalin e datës 14.07.2021 të drejtuar Emalin e datës 15.07.2021 të drejtuar Shkresën e datës 14.07.2021; Shkresën e datës 14.07.2021 të bashkangjitur se bashku me foton lidhur me veturën e dëmtuar; Emalin e datës 14.07.2021 të drejtuar ; Emalin e datës 14.07.2021 të drejtuar ; Emaili e datës 15.07.2021 të drejtuar Emalin e datës 30.07.2021 të drejtuar

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Bazuar në provat e administruara, gjegjësisht Akt-in e Emërimit me numër protokollit 06/623 të datës 30.04.2012, rezulton së ankuesi është e punësuar në pozitën e punës "Udhëheqës i Zyrës Rajonale në Mitrovicë" në kuadër të Departamentit të Inspektoratit Farmaceutik të Produkteve Medicinale në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale.

Po ashtu nga provat e administruara të lëndës rrjedh se ankuesi _____ së bashku me kolegun e tij, inspektorin _____, me datë 13.07.2021, kanë qenë të angazhuar për inspektim në qendrën e vaksinimit në Gjakovë, dhe se të njëjtit në shfrytëzim kanë pasur makina Suzuki me targa 3Z-016-12. Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezulton se inspektorët në fjalë gjatë kthimit nga puna në teren kanë vërejtur një defekt të jashtëm të makinës zyrtare për të cilin defekt, të nesërmen në mëngjes është lajmëruar rasti të udhëheqësi i Divizionit për Teknologji Informative dhe Logjistike.

Drejtoresha e Departamentit të Inspektoratit Farmaceutikë, pas marrjes së informacionit lidhur me defektin e paraqitur në automjetin zyrtar me targa 3Z-016-12, me datë 30.07.2021, ndërmerri veprime disiplinore me ç'rast inspektorit _____ dhe _____ i'u shqipton masën disiplinore "Vërejtje".

Kundër kësaj mase disiplinore, ankuesi _____, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit _____, me datë 19.08.2021 parashtroi ankesë, me pretendimin ankimor së masa disiplinore e kundërshtuar më ankesë është shqiptuar me shkelje të dispozitave procedurale, aplikimit të gabuar të drejtës materiale, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase i njëjti ndonëse pranon të jetë pjesëmarrës në kompensimin e dëmit thekson se ai dhe kolegu i tij nuk kanë qenë në dijeni lidhur me defektin e veturës derisa janë njoftuar nga një qytetar tjetër. Po ashtu ankuesi thekson se në ditën kur është realizuar vizita në teren, me datë 13.07.2021, ai nuk ka qenë duke vozitur veturën, ngase vetura është marr dhe gjatë gjithë kohës është vozitur nga kolegu i tij,

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 45 ku përcaktohet se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit",* dhe si rrjedhojë bazuar në këtë dispozitë ligjore, si dhe nga analizimi i aktit të kontestuar me ankesë, gjegjësisht e-mailit zyrtar të datës 30.07.2021 me të cilën ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore e vërejtjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se akti i kontestuar është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e ligjit material ngase në rastin konkret mbikëqyrësi i drejtpërdrejt me rastin e përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore dhe rrjedhimisht shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit, i është referuar vetëm ekzistimit të pasojës/dëmit material të automjetit zyrtar, mirëpo nuk ka arritur të vërtetoj paraprakisht ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit në raport me ankuesin si dhe lidhjen shkakore në mes të veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, ngase ankuesi pretendon se në ditën kur është realizuar vizita në teren, me datë 13.07.2021, ai nuk ka qenë duke vozitur veturën zyrtare, deri sa thekson se vetura është marr dhe gjatë gjithë kohës është vozitur nga kolegu i tij, _____, ndërsa mbikëqyrësi i drejtpërdrejt me asnjë provë nuk ka arritur të vërtetoj të kundërtën e kësaj.

Me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.03/2008 për Përdorimin e Automjeteve Zyrtare, përkatësisht nenin 6 paragrafi 2 përcaktohet se: *Çdo nëpunës civil i ministrisë përkatëse i cili ka nevojë të përdorë automjetin zyrtar përkohësisht, për udhëtime zyrtare, pa vozitës, duhet të plotësoj formularin-*

Kërkesë për përdorim të përkohshëm të automjetit zyrtar (Shtojca 2), të miratuar nga drejtori i departamentit përkatës, ndërsa me paragrafin 4 të këtij akti përcaktohet se: Çdo drejtues i automjetit zyrtar është i obliguar që para pranimit-dorëzimit të automjetit zyrtar të plotësoj formularin e Gjendjes së automjetit (Shtojca 4), pasi të ketë kryer kontrollin e automjetit dhe të jetë bindur që ky i fundit është në gjendje të mirë pune, para se ta firmos atë, derisa me nenin 7 të këtij udhëzimi administrativ përcaktohen përgjegjësit e drejtuesit të automjetit lidhur me mirëmbajtjen dhe inspektimin e automjetit me rastin e shfrytëzimit, nga rrjedh se përgjegjës për mirëmbajtjen dhe inspektimin e automjetit zyrtar me rastin e shfrytëzimit të përkohshëm bije mbi personin i cili nënshkruar formularin për përdorim të automjetit dhe është vozitës i automjetit.

Andaj, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, menaxheri drejtues, pas marrjes së informacionit në lidhje me defektin e paraqitur në automjetin zyrtar, fillimisht është dashur të vërtetohet faktin nëse ankuesi ka nënshkruar formularin për përdorim të automjetit zyrtar, me targa 3Z-016-12, dhe për pasojë faktin nëse i njëjti kishte vozitur këtë automjet zyrtar, apo ishte vetëm pasagjer, me datë 13.07.2021, dhe vetëm pas vërtetimit të faktit lidhur me cilësinë e ankuesit, është dashur të ndërmerren veprime për vërtetimin e përgjegjësisë në kuptimin e përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga neni 7 i Udhëzimit Administrativ Nr.03/2008 për Përdorimin e Automjeteve Zyrtare.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës si dhe analizimi i aktit të kundërshtuar me ankesë ka gjetur se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike ngase nuk është vërtetuar paraprakisht fakti nëse ankuesi, me datë 13.07.2021, ka qenë duke vozitur veturën zyrtare të dëmtuar, dhe se në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, në rrethanat e rastit konkret ky ishte fakti vendimtar lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, kështu që dështimi për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ka bërë që akti i kontestuar në ankesë të jetë në kundërshtim edhe me ligjin material, ngase në rastin konkret shihet se nuk janë plotësuar në mënyrë komulative elementet e përgjegjësisë disiplinore të përcaktuara me dispozitat e nenit 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Rrjedhimisht, arsyetimi i aktit të goditur me ankesë nuk përmban shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, andaj si i tillë është dukshëm i pamjaftueshëm apo i barabartë me mungesën e tij, duke bërë që të jetë në kundërshtim edhe me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 si dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, duke marr parasysh konstatimin si me lartë se akti i goditur me ankesë përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore e vërejtjes, është përcjell me shkelje të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të ligjit material, Kolegji i Këshillit konstaton pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara dhe se akti i goditur me ankesë, gjegjësisht masa disiplinore e shqiptuar me datë 30.07.2021 ndaj ankuesit është e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4, 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe dispozitat e nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.739/2021

Ilire Mehmeti Shaqiri

Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, avokati
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

